



Koncepti “Kitab” në Kuran

Description

Muhamed Hadi Marifat

Fjala kitab do të thotë të grumbullosh dhe rrënja e tij është Katb. Ahmed Ibn Faris thotë se gërmat k,t,dhe b përbëjnë rrënjën e fjalës kitab. Fjalët si kitabat dhe kitab rrjedhin prej së njëjtës rrënjë. Rahib Isfahani, dijetar i njohur i Isfahanit të shekullit të pestë Hixhra si dhe autor i Mufraditu Alfaz Kuran shkruan: “katb” do të thotë të ngjitësh dy pjesë të lëkurës apo të bashkosh së bashku këto dy pjesë.” Të shkruarit është quajtur kitabet është “e shkruar” kur shkronjat dhe fjalët vendosen së bashku. Ibn Faris deklaron se kur trespihët shkohen në një fill, quhet kutbeh. Kësisoj Hurzeh (tesbih) quhet Kutbeh dhe shumësi i saj është kutab si shumësi i Hurzeh është Hurez. Raghib më tutje shkruan: Kitaba në parim është një lloj bashkimi fjalësh me njëra-tjetrën. Nga ndonjëherë termi Kitabat i referohet ligjërimit i cili nuk mund të jetë në formë të shkruar. Prandaj, fjala Hyjnore është po ashtu kiteb. Duke marrë në konsideratë ajetet: “Ky është kitab (libër), ku nuk ka asnjë dyshim” (2:1) megjithëse nuk është në formë të shkruar, “Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i All-llahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë Pejgamber.” (19:30). Këtu kitab i referohet fjalës Hyjnore. Kitab në ajetin e sipër përmendur i referohet Sheriatit (ligjit fetar). Kitab i referohet po ashtu fjalive kur ato bashkohen së bashku. Ragib është i mendimit se kitab i referohet asaj çka është e detyrueshme. Pasi, çdo material i shkruar fillimisht është i planifikuar, i para përcaktuar apo i para kërkuar. Me fjalë të tjera, fillimisht një projekt zakonisht shqyrtohet a përcaktohet, pastaj shfaqet në formën e shkruar. Mund të thuhet se dëshira a vullneti është origjina dhe kitabat është përfundimi. Kështu ata i japin emër përfundimit për atë çka dëshirohet për të theksuar dëshirën. Edhe në Kuran fjala kitab i referohet asaj çka është e detyrueshme dhe e domosdoshme. Merr për shembull ajetet e mëposhtme të Kuranit:

“All-llahu ka përcaktuar (shkruar në Levhi Mahfudh): “Unë dhe të dërguarit e Mi patjetër do të ngadhënjëjmë!” All-llahu është i fortë, ngadhënjyës.” (51:21)

“Thuaj: “Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na është shkruar (caktuar) nga All-llahu; Ai është ndihmëtar yni”. (9:51)

“Farefisi ka më përparësi ndaj njëri-tjetrit (se sa ensarët e muhaxhirinët) në librin e All-llahut.” (8:75)

“Ne shkruam për to: njeriu (mbytet) për njeriun, syri për syrin, hunda për hundën, veshi për veshin, dhëmbi për dhëmbin, por edhe plagët kanë kundërmasë. E kush e falë atë (hakmarrjen), ajo është shpagim (nga mëkatet) për të. E kush nuk vendos sipas asaj që zbriti All-llahu, ata janë mizorë (të padrejtë).” (5:45)

“E përcaktuar për ju është që kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejt. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.” (2:180)

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (2:183)

Kësisoj, urdhri është gjithashtu një lloj Kitabat, pasi bashkon shkronjat dhe fjalët së bashku. Po ashtu, kitab në arabisht do të thotë libër, pasi bashkon faqet e shkruara. Kitab paraqet urdhrat hyjnorë kur shfaqet në formën e Sheriatit (ligjit hyjnor) dhe formës së shkruar. Urdhrat hyjnorë (të shkruar) janë të detyrueshëm për publikun.

“..., pse namazi është obligim (për kohë) i caktuar për besimtarët.” (4:103)

Termi kitab ka kuptimet e mëposhtme në Kuran:

1. Sheriat (ligj fetar): urdhrat hyjnorë dhe detyrat njerëzore, të dyja kolektive dhe individuale, janë në Kitab në formë të shkruar. Zakonisht, njerëzve u kërkohet të ndjekin urdhrat fetare. Dhe ajo çka u kërkohet nga ata është zakonisht e shkruar dhe e grumbulluar në një libër. Ky kuptim i kitab-it përsëritet 120 herë në Kuran: Kur Profeti Jezus ishte një foshnje, i shtrirë në djep, tha:

“Ai (Isai) tha: “Unë jam rob i All-llahut, mua më ka dhënë librin dhe më ka bërë Pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqatë për sa të jem gjallë!”(19:30-31)

Në atë kohë Profeti a.s. nuk kishte marrë ndonjë libër apo shkruar ndonjë rregull, në këtë mënyrë, kitab në këtë ajet i referohet Sheriatit. Ishte një profet me një sheriat dhe urdhra fetare që ishte i detyrueshëm për njerëzit që i bindeshin atij.

Një vështrim i shpejtë në ajetin 110 të sures pestë të Kuranit fisnik (...kur ta mësova ty librin e urtësinë Tevratin e Inxhilin...) dëfton se në disa raste kitab as nuk i referohet Biblës as Teuratit, por nënkupton Sheriatin. Ky ajet nënvizon se Zoti i mësoi Jezusit Sheriatin dhe Hikmeh (diturinë) si edhe Biblën dhe Teuratin. Le të studiojmë ajetin e mëposhtëm të Kuranit po ashtu:

“Zoti ynë, dërgo ndër ta, nga gjiu i tyre të dërguar që t’u lexojë atyre ajetet Tua, t’u mësojë atyre librin dhe urtësinë, e t’i pastrojë (prej ndytësisë së idhujtarisë) ata. S’ka dyshim se Ti je ngadhënjyesi, i dijshmi.” (2:129)

Këtu përmendja i referohet sjelljes së shenjave hyjnore në vështrimin e tyre. Ai mandej deklaroi se Ai i mësoi atyre Librin, d.m.th. Sheriatin dhe Hikmeh për t’i pastruar ata. Ai asnjëherë nuk nënkuptoi që t’u mësonte atyre Kuranin. Në gjithë ajetet që përmbajnë shprehjet, “Mësojë atyre librin” dhe “mësojë ty

librin” , mësimi i librit i referohet mësimin të ligjeve të Sheriatit. Duke marrë për shembull ajetet e mëposhtme të Kuranit: 2:151-282, 3:104, 62:2.

Si rrjedhim shprehja “O njerëz të librit” e cila i referohet hebrenjve dhe të krishterëve në Kuran, në fakt i referohet njerëzve të Sheriatit dhe nuk ka të bëjë fare me librin e shkruar. Kështu nëse vërtetohet se zjarrputistët dhe budistët kanë Sheriat hyjnor, atëherë ata mund të konsiderohen si “njerëz të librit” pavarësisht mos patjes së një libri hyjnor të shkruar apo jo. Në ajetin:

“...por devtoshmëri e vërtetë është ajo e atij që i beson All-llahut, ditës së gjykimit, engjëjve, librit, peygamberëve” (2:177)

Libri i referohet Sheriatit dhe detyrave hyjnore, të ndjekura në mënyrë të njëpasnjëshme. Libri në këtë ajet nuk shqetësohet për librin e profetëve, pasi ai nuk është në shumës ndërsa engjëjt dhe profetët janë në shumës.

Meqënëse Sheriati është një, libri në këtë ajet është shkruar në numrin njëjës.

“Njerëzit ishin një popull e All-llahu dërgoi peygamberët përgëzues dhe qortues, dhe atyre Ai u zbriti edhe librin me fakte të sakta ” 2:213

Në ajetin e mësipërm, fjala i referohet Sheriatit, pasi Sheriati ishte gjithmonë me Profetët jo librin, sepse shumica e tyre nuk kishin libra. Kësisoj, këtu fjala libri i referohet Sheriatit. Si një fakt i përgjithshëm në Kuran, “libri” shoqërohet me fjalën “dije”, dhe nënkupton Sheriatin siç është rasti i ajetit në mëposhtëm:

“Përkujtoni të mirat e All-llahut ndaj jush edhe atë që ua shpalli Kur’anin dhe dispozitat e sheriatit me të cilat ju udhëzon, dhe keni frikë All-llahun e dini se All-llahu është i gjithëdijshëm për çdo send.” (2:231)

Në ajetin:

“Përkujtoni (o ithtarë të librit) kur All-llahu mori zotimin e peygamberëve: Nga ajo se juve ju dhashë libër e urtësi, ju patjetër do ta besoni dhe ndihmoni peygamberin që vjen pas juve, e që vërteton atë që ju keni pranë vetes...(3:81)

Duke u mbështetur në arsyet e dy ajete të mëposhtme libri i referohet Sheriatit: i) libri ndiqet nga dija; ii) ai i adresohet gjithë Profetëve. Në ajetin e mëposhtëm:

“A u kanë zili atyre njerëzve për atë që All-llahu u dha nga mirësitë e Tij? Ne u patëm dhënë pasardhësve të Ibrahimit librin e sheriatin dhe u patëm dhënë atyre pushtet të madh.” (5:54)

Ishte Sheriati dhe jo libri ai që iu dha popullit të Abrahamit. Në të vërtetë, populli i Abrahamit kishte vëmendje të veçantë nga i Gjithëmëshirëshmi. Si rrjedhim, Ai i dha atyre mbretëri të fuqishme. I njëjti konotacion dëshmohet nga ajetet e mëposhtme: (2:129-151), (3:48-164), (4.113), (62:2).

2. Shkrim i shenjtë: Një tjetër kuptim i Kitab është libër apo shkrim i shenjtë, i cili përmendet në Kuran tetëdhjetë herë. Për shembull, ajetet e mëposhtme dëftojnë të njëjtin kuptim:

“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruajshe atë me dorën tënde të

djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.”(29:48).

“Shko me këtë letrën time e hidhja atyre, largohu (pak) nga ata dhe përgjo se çka bisedojnë! Ajo (gruaja – Belkisa) tha: “O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!” (e lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) “Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!” (Bismil-lahir-Rrahmanir-Rrahim!) (në vazhdim shkruan) “Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (dhe besimtarë)!” (27:28-31)

“E ai i cili kishte dituri nga libri tha: “Unë ta sjell atë ty sa çel e mshel sytë (këtij i tha sille)!” E kur e pa atë (fron) të vendosur pranë tij, (Sulejmani) tha: “Kjo është dhuntia e Zotit tim që të më sprovtojë mua se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuz. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbuz, Zoti im (s’ka nevojë), është i pa nevojë e bujar!” (27:40)

Ekzistojnë dallime mendimesh për sa i përket kuptimit të librit në këtë ajet. Disa interpretime janë të mendimit se ai i referohet “Libri i Qartë” i cili e ka origjinën nga dija e përjetëshme e Zotit. Të tjerët e konsiderojnë atë “Emrin më të Lartë (të Zotit). Shumica e dijetarëve e konsiderojnë atë një rreze të dijes hyjnore. [2]

Megjithatë, ka mundësi se ajo i referohet dijes së materialit të shkruar, e cila personifikon të qenurit i njohur dhe ballafaqimit me librin. Për shembull, ajeti i mëposhtëm:

“Thuaj: “Zoti më mjafton si dëshmitarë midis meje dhe jush, dhe çdokujt që posedon dije për librin” (13:40)

Njohja e librit do të thotë të qenurit i mësuar, pasi zakonisht të mësuarit e ndjekin të vërtetën. Ajetet e mëposhtme e mbështesin këtë pikëpamje:

“Thuaj: “I besuat ju atij ose nuk i besuat (atij nuk i bëhet dëm), e atyre që u është dhënë dijeni para tij, kur u lexohet atyre, ata hedhen me fytyra (përdhe) duke i bërë sexhde”. (17:107)

“E, edhe për ta vërtetuar të dijsmit se me të vërtetë ai (Kur’ani) është i vërtet prej Zotit tënd dhe kështu t’i besojnë atij (Kur’anit) dhe (zemrat e tyre) të binden ndaj tij. E All-llahu patjetër do t’i udhëzojë ata që besuan (përqafuan) në rrugën e drejtë.” (22:54)

“Ndërsa atyre që u është dhënë dijenia, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti, është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqplotit, të lavdishmit.” (34:6)

“All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është Zbatues i drejtësisë. Nuk ka zot përveç Tij, Fuqplotit e të Urtit.” (3:18)

“A nuk ishte për ata (për jobesimtarët mekas) argument, se atë e dinin dijetarët (ulemaja) e beni israilëve?” (26:197)

Si përfundim, Kurani i ka dhënë një pozitë të lartë të diturve. Sipas Kuranit ata që zotërojnë dijen e Librit dhe besojnë tek e vërteta, janë po të njëjtit të mësuar që përbahen me librat.

3. Dija e përjetshme hyjnore. Një tjetër kuptim i termit kitab ka lidhje me dijen hyjnore të përjetshme

dhe ky kuptim i fjalës përdoret njëzet herë në Kuran. Megjithatë, fraza të ndryshme përdoren si të tilla Kitabun Mubin, Kitabun Melum, Ummul Kitab, El Kitab, etj. Gjithë këto terma personifikojnë Dijen hyjnore të përjetëshme. Diku tjetër, ne hasim termin el Luuh el Mahfush(Librin e Qartë).

“Celësat e fshehtësive janë vetëm te Ai, atë (fshehtësinë) nuk e di kush pos Tij. Ai e di çka ka në tokë dhe në det, Ai e di për çdo gjeth që bie dhe s’ka kokërr në thellësi të tokës, s’ka të njomë dhe s’ka të thatë që nuk është (shënuar) në librin e qartë (Levhi – Mahfudh).” (6:59)

Kitabun Mubin është një shkrim i shenjtë eksplicit i lirë a i mangut nga ndonjë gabim a dykuptimësi, domethënë, çdo gjë është e qartë për ne si një dorëshkrim i qartë.

“Ti nuk angazhohesh me asnjë çështje, nuk lexon nga ai pjesë nga Kur’ani dhe nuk bëni ndonjë vepër, vetëm se ne jemi prezentuesit tuaj, kur ju ndërmerrni atë. Zotit tënd nuk mund t’i fshihet as në tokë e as në qiell as sa grimca e as më e vogël se ajo e as më e madhe, por vetëm sa është evidentuar në librin e sigurt.” (10:61)

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë që All-llahu të mos ia ketë garantuar furnizimin e saj, Ai e di vendbanimin dhe vendstrehimin e saj (pas vdekjes). Të gjitha (këto) janë në librin e njohur (Levhi Mahfudhë).(11:6)

Këtu vendbanimi dhe vendstrehimi i referohet vendeve të përjetëshme dhe jetë së kësaj bote.

“Nuk ka asgjë të fshehur në qiell e as në tokë, e të mos jetë e shënuar në librin e saktë (dijen e Zotit).” (27:75)

Ky ajet dëfton se çdo gjë ekziston me dijen e përjetshme të Zotit. Po ashtu, Kitebun Hafiz (Libri i regjistrimit) dhe Kitebun Muknun (librin e fshehur) në ajetet e mëposhtme i referohet Librit të qartë, d.m.th. Dijes së Përjetshme Hyjnore.

“Ne dimë se ç’pakëson (ç’tret) toka prej tyre. Te Ne është edhe libri që ruan çdo gjë (numrin e tyre, emrat, pjesët e trupit).” (50:4)

“???????Eshtë në një libër të ruajtur.” (56:78)

Ummul Kiteb (Esenca e librit), e përmendur dy herë në Kuran i referohet “Librit të qartë” i cili është burimi i gjithë mësimëve.

“All-llahu shlyen (nga ajo evidencë) çka të dojë, edhe forcon (çka të dojë). Vetëm tek Ai është baza e librit (Levhi Mahfudhi).” (13:39)

Kjo është, Ummul Kiteb (Esenca e Librit) është me Zotin dhe Ai e di se çfarë do të ndodhi.

“S’ka dyshim se Ne e bëmë atë Kur’an arabisht, në mënyrë që ju ta kuptoni.

Dhe se në librin amzë (Levhi Mahfudh) te Ne, gëzon famë të lartë dhe është plot urtësi.” (43:3-4)

4. Fati dhe paracaktimi: Një prej kuptimeve të Kitab-it në Kuran është fati dhe paracaktimi:

“Nuk ka asnjë gjallesë në tokë dhe as shpendë që fluturojnë me dy krahë e që nuk janë të ndara në

grupe (të ndryshme), sikurse edhe ju (Zoti i krijoi, i pajisi si juve). Asgjë nuk kemi lënë pas dore nga evidenca. Më në fund te Zoti i tyre do të tubohen.” (6:38)

“Ndërsa Ne çdo send e kemi ruajtur me shkrim të saktë.” (78:29)

“Ne u kumtuam në libër beni israilëve: “Ju do të bëni shkatërrime dy herë në tokë dhe do të tejkaloni duke bërë zullum të madh”.(17:4)

“Nuk ka asnjë nga fshatrat (nga vendbanimet e kundërshtarëve) e që Ne nuk do ta shkatërrojmë ose ndëshkojmë atë me një dënim të ashpër para ditës së kijametit. Kjo është theksuar në Libër (Lehvi Mahfudh).” (17:58)

Ajetet e më mëposhtme po ashtu mbartin të njëjtin kuptim: (20:52), (22:5) dhe (8:68).

5. Kuran: Një tjetër kuptim i Kitab është Kurani. Pasi është e ditur se Kurani është një shpallje në formën e shkrimit të shenjtë. Quhet Kuran, pasi lexohet. Quhet Kitab, pasi është një dorëshkrim. Kësisoj, Kuran dhe Kitab përdoren për këtë libër. Ajetet e mëposhtme nënkuptojnë këta emra:

“All-llahu është Ai që e zbriti librin e vërtetë dhe drejtësinë. Ti nuk mund ta dish, ndoshta çasti i shkatërrimit është afër.” (42:17)

“Pasha Librin e qartë vërtet ne e kemi sjellë Kuranin në gjuhën arabe...”

“Ky është libri që nuk ka dyshim në te (sepse është prej All-llahut) është udhëzues për ata që janë të devotshëm.” (2:2)

Në Kuran, Kitebi i referohet Kuranit në vetvete në më shumë se dyzet herë.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi